REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

P R O J E K T L I G J

Nr. _____/2026

PËR

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.92/2014, "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR[1]

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 48 "Shkalla standarde", togfjalëshi "... 20 për qind." zëvendësohet me "... 21 për qind.".

Neni 2

Në nenin 49 "Shkallët e reduktuara" bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në pikën 3, togfjalëshi "... 6 për qind." zëvendësohet me "... 10 për qind.".

2. Në pikën 4, togfjalëshi "... 6 % ..." zëvendësohet me "...10 % ...".

3. Pas pikës 10 shtohet pika 11, me këtë përmbajtje:

[1] *Ky ligj është përafruar pjesërisht me: Direktivën e Këshillit 2006/112/KE e 28 nëntorit 2006 "Mbi sistemin e përbashkët të tatimit mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar.*

"11. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e produkteve ushqimore, si bukë dhe miell, qumësht dhe kos natyral, vezë, oriz, makarona, vaj ushqimor, mish pule, mish viçi/derri, peshk bazë, fruta të freskëta, perime të freskëta, bishtajore, sheqer, ushqime bazë për foshnja, është 6 për qind. Lista e detajuar e produkteve ushqimore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 3

Në pikën 3, të nenit 146 "Objekti i skemës së kompensimit", fjalët "..., me shkallë standarde 20 për qind ..." hiqen.

Neni 4

Në pikën 2, të nenit 155/3 "Pagesa e TVSH-së", fjalët "Deri më 31 dhjetor 2026 ..." hiqen.

Neni 5

Pas nenit 155/3 "Pagesa e TVSH-së" shtohet neni 155/4, me këtë përmbajtje:

"Neni 155/4
Afati i zbatimit

Regjimi i veçantë për Bursën Shqiptare të Energjisë, sipas këtij seksioni, zbatohet deri në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.".

Neni 6

Në nenin 159 "Nxjerrja e akteve nënligjore" shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

"Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e aktit nënligjor në zbatim të pikës 11, të nenit 49, të këtij ligji, brenda datës 15 janar 2027.".

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në "Fletoren zyrtare" dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2027.

K R Y E T A R I

NIKO PELESHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr._____, datë _____

PËR

PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT "PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.92/2014, "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Propozimin e projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar", për shqyrtim e miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit dhe relacionit që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

MINISTRI I FINANCAVE

PETRIT MALAJ